



RREGULLORE  
PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS  
SPORTIVE  
"ADEM JASHARI"  
KLINË

Dhjetor, 2016

Ne baze te nenit 12.2 Ligjit per Veteqeverisje Lokale, Nr.03/L-40, Gazeta Zyrtare e Republikes se Kosovës, Nr.28/2008,nenit 40 tëStatutit të Komunës së Klinës, Nr.01-110-1232/2010 të dt.31.03.2010, me propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinise dhe Sportit,Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vete te rregullt të mbajtur më dt.29.12.2016 miratoi,**këtë:**

## Rregullore Për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” në Klinë

### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve “Adem Jashari” në Klinë, për aktivitetet sportive të klubeve të licencuara në federatat gjegjëse, si dhe klubeve private, për manifestime të ndryshme kulturore, tubime partiake, revista ose rekreacion.

### Neni 2

1. Klubet dhe subjektet tjera të interesuara për shfrytëzimin e Palestrës së Sporteve duhet që së paku tri ditë para mbajtjes së manifestimit, tubimit apo ndeshjes t’i drejtojnë një kërkesë me shkrim menaxherit të Palestrës Sportive (DKRS), i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.

2. Klubet sportive publike të Komunës së Klinës të cilat janë të licencuara në federatat gjegjëse dhe që kanë kalendarin e rregullt të garimeve dhe stërvitjeve nuk i nënshtrohen paragrafit 1 te këtij neni.

### Neni 3

Palestra e Sporteve mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme sipas këtij kompensimi:

- a). Për ngjarje komerciale (panaire, revy, ekspozita ,dhe të ngjashme)-----100 € (për një dite);
- b). Për ngjarje humanitare-gratis;
- c). Për koncerte 30% nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pagesa fikse sipas marrëveshjes.

### Neni 4

Të gjitha klubet sportive që nuk janë të Komunës së Klinës, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën Sportive në Klinë, duhet të paguajnë 50€ për një orë.

### Neni 5

1. Përveç klubeve të rregullta, Palestrën e Sporteve mund ta shfrytëzojnë edhe klubet sportive private, shoqata si dhe organizata punuese për qëllime rekreative por janë të obliguara të paguajnë për një orë:

- Pa ndriçim ----- 10 €
- Me ndriçim-----15€

2.Për shfrytëzimin e palestrës për turnir

- Pa ndriçim ----- 10 €
- Me ndriçim-----15 €

Për zhvillimin e turnirit me bileta 20 % nga mjetet e inkasuara të biletave.

3. Klubet sportive te cilat kanë të hyra vetanake, për shfrytëzimin e Palestrës Sportive për ore paguajnë:

- Pa ndriçim ----- 15 €
- Me ndriçim ----- 20 €

4.Kampionatet kombëtare e ndërkombëtare në marrëveshje me organizuesin 30% nga shitja e biletave.

5. Për fushata të grupeve politike, subjekteve dhe koalicioneve, shfrytëzimi i sallës sportive për një orë paguajnë 100 €.

#### Neni 6

1. Palestra e Sporteve mund t'iu lejohet për shfrytëzim edhe organizatave të ndryshme për koncerte apo shfaqje të ndryshme,duke paguar kompensimin prej 30% të mjeteve të inkasuara.

2. Prej këtyre obligimeve lirohen organizimet shtetërore apo manifestimet me karakter kombëtar, në qoftëse organizatori nuk inkason të hyra nga shitja e biletave.

3. Lirohen shoqatat me aftësi të kufizuara, OVL të UÇK-së.

4. KFOR-i,PK-ja, FSK-ja sipas kërkesave lirohen me marrëveshje të veçante 2 orë gratis në muaj.

#### Neni 7

Kompanitë televizive mund t'i transmetojnë nga pallati i sporteve sipas marrëveshjeve paraprake me organizatorin.

#### Neni 8

1. Subjekteve të interesuara ju mundësohet vendosja e reklamave të tyre sipas këtyre tarifave:

1.1. Vendosja e reklamave me dimensione për një muaj:

a).në qendrën e fushës së basketbollit, në parket.....150 €;

b).në gjysmërrethin e rektit të fushës së basketbollit.....50 €;

c).në hapësirën e 6-metërshit të fushës së hendbollit .....2X 0.60m.....50€ ;

d).në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit..... 2 X 0.60m.....50 €;

e).rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit.....3 X 0.60m.....40 €;

f).në pjesën anësore (veriore dhe jugore në muri) të palestrës ..... 3 X 0.60m.....50 €;

g).në pjesët tjera të palestrës dimensiononi..... 2 X 0.60m.....35€;

2. Kohëzgjatja e vendosjes së reklamës në vendin e zgjedhur do të jetë për një vit, me të drejtë vazhdimi përmes kontratës së re;

3. Vendi vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të kontratës;

4. Shpenzimet e shkrimit dhe vendosjes së reklamës i bartë subjekti i interesuar;

5. Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo tre muaj dhe atë në fillim të periudhës tre mujore;

6. Në palestrën e sporteve, klubet mund të ekspozojë reklamën lëvizëse të sponsoreve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamën ekzistuese në palestër;

7. Klubet e interesuara për vendosjen e reklamave në qendër të fushës (në parket) duhet të paguajnë çmimin sipas tarifave nga neni 8;

8. Në rastet ku paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njëjtin vend , përzgjedhja do të bëhet me licitacion.

#### Neni 9

Në Palestrën e Sporteve nuk lejohet mbajtja e armëve, mjeteve eksplozive, pirja e duhanit dhe alkoolit. Personat të cilët mund të hasen këto mjete, do të largohen nga Palestra e Sporteve,me përjashtim të formacioneve të rregullta të caktuara për mbajtjen e rendit.

#### Neni 10

1. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse, përgjegjësia bie teshfrytëzuesit gjatë kohës, andaj kompensimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhirollogarinë e Komunës së Klinës .

2. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anetareve të emëruar nga Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport dhe evidenton dëmet e shkaktuara. Në rast të mos kompensimit të dëmeve në afatin e paraparë kohor, procedura e kompensimit do të vendoset përmes organeve gjyqësore, përfshirë kamatën ligjore (si dhe ndalesën për shfrytëzuesin deri në zgjedhjen e kontestit).

#### **Neni 11**

Për shfrytëzimin e Palestrës së Sportit bëhet kontrata me shkrim ndërmjet Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhënësi i objektit në shfrytëzim në njërën anë dhe përfaqësuesit të klubit apo subjektit tjetër përkatës në anën tjetër, si shfrytëzues.

#### **Neni 12**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa Kryetari i Komunës e përcjell implementimin e saj.

#### **Neni 13**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore bëhet sipas procedurës së nxjerrjes së të njëjtës.

#### **Neni 14**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës, në kuptim të nenit 18 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

### **KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS**

01Nr. 06-143 /2017  
Klinë, dt. 13/01/2017

